

## **Hapet thirrja për bursa në kuadër të Programin Erasmus + në South-West University “Neofit Rilski”, në Bullgari, për semestrin e dytë të vitit akademik 2021-2022.**

Universiteti i Tiranës hap thirrjen për aplikime për bursa për mobilitete në South-West University “Neofit Rilski”, në Bullgari në kuadër të programit Erasmus +, për studentët e Universitetit të Tiranës, për semestrin e dytë të vitit akademik 2021-2022.

<http://en.swu.bg/>

### **Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

-Shkëmbimin e studentëve për studime;

### **Nivelet e mobilitetit për studentët:**

- Bachelor;
- Master;

### **Kohëzgjatja e bursave:**

- Bachelor (1 semestër);
- Master (1 semestër);

### **Fushat e studimit:**

- Gjuhë Bullgare;
- Gjuhë Ruse (Applied linguistics with Russian);
- Gjuhë Angleze (English Philology, Applied Linguistics, English Language and Ethnology);
- Gjuhë Gjermane (Applied linguistics with German);
- Gjuhë frënge (Applied Linguistics with French);

Për t’u njohur me katalogun e programeve të studimit të ofruara nga South-West University “Neofit Rilski” klikoni në:

<http://en.swu.bg/>

### **Bursat përfshijnë:**

- Kompensimin mujor (800 EUR në muaj për studentët);
- Kostot e udhëtimit (180 EUR);

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifatat e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

### **Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët Bachelor:**

- CV;

- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti i nivelit Bachelor (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze);
- Listë notash (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze);
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Certifikatë e gjuhës së huaj B2 (Bullgarisht/Anglisht/Rusisht/Gjermanisht/ Frëngjisht, në varësi të programit të studimit);
- \*Learning Agreement;

*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the Mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në universitetin pritës lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin e dytë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvillohen lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.*

*Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset fillimisht nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe më pas në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +. Nëse studenti bën ndryshime të lëndëve gjatë mobilitetit, pjesa During mobility duhet të firmoset nga personi përgjegjës në fakultet dhe më pas nga personi përgjegjës në Rektorat.*

*Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:*

[https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Learning\\_agreement\\_for\\_studies\\_Erasmus\\_outgoing-2-1.docx](https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Learning_agreement_for_studies_Erasmus_outgoing-2-1.docx)

### **Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Master:**

- CV (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti të nivelit Master (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze);

- Listë notash e nivelit Bachelor (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);
- Listë notash e nivelit Master (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Certifikatë e gjuhës së huaj B2 (Bullgarisht/Anlisht/Rusisht/Gjermanisht/ Frëngjisht, në varësi të programit të studimit);

-\*Learning Agreement;

*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the Mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në universitetin pritës lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin e dytë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvillohen lëndët që nuk përshatën në Universitetin e Tiranës.*

*Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset fillimisht nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe më pas në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +. Nëse studenti bën ndryshime të lëndëve gjatë mobilitetit, pjesa During mobility duhet të firmoset nga personi përgjegjës në fakultet dhe më pas nga personi përgjegjës në Rektorat.*

*Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:*

[https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Learning\\_agreement\\_for\\_studies\\_Erasmus\\_outgoing-2-1.docx](https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Learning_agreement_for_studies_Erasmus_outgoing-2-1.docx)

**Afati për aplikim: 18 Nëntor 2021**

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al).

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al)

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikim!